

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Frosina Sylejmani - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.M.1 nga ..., të cilën me autorizim e përfaqëson av. M.I. nga Ferizaji, kundër të paditurës Komuna e Shtërpcës, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e saj M.M.2., me objekt të padisë vërtetimin e të drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë C.nr.22/12, të datës 20.04.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **30.10.2018**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses M.M.1 nga ..., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë C.nr.22/12, i datës 20.04.2014, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.22/12, të datës 20.04.2014, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses M.M.1 nga ..., e parashtruar kundër të paditurës Komuna e Shtërpcës, me të cilën ka kërkuar që “të vërtetohet se paditësja sipas bazës së mbajtjes se shumë viteve dhe shfrytëzimit ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmerinë e cila është regjistruar si ngastër kadastrale me nr.1419, sipas fletës poseduese 628 ZK Shtërpcë dhe e paditura t’i pranojë këtë të drejtë, ndërsa Shërbimi për Kadastër dhe Paluajtshmëri i Komunës së Shtërpcës të obligohet që nga forma e prerë e aktgjykimit të kryej ndryshimet e nevojshme në aparatin kadastral, ashtu që si pronare të ngastrës së lartë përmendur t’a regjistroj paditësen, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit të formës së prerë, si dhe e paditura të obligohet që t’i paguajë shpenzimet e procedurës”. Ndërsa në pjesën e dytë të dispozitivit, ka vendosur që shpenzimet e procedurës në shumën prej 30 euro në emër të taksës gjyqësore për ushtrimin e padisë dhe për përpilimin e aktgjykimit, t’i bartë paditësja.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, ka paraqitur ankesë paditësja përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljeve nga të gjitha shkaqet e nenit 181 të LPK-së, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj ashtu që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar e paditura Komuna e Shtërpcës.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

-Ankesa e paditëses është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në gjykatën e shkallës së parë paditësja me datën 04.04.2012, ka paraqitur padi për vërtetim e të drejtës së pronësisë në bazë të ndërtimit në tokën e huaj dhe mbajtjes, me kërkesë që të vërtetohet se paditësja sipas bazës së mbajtjes se shumë viteve dhe shfrytëzimit ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmerinë e cila është regjistruar si ngastër kadastrale me nr.1419, sipas fletës poseduese 628 ZK Shtërpcë dhe e paditura t'i pranojë këtë të drejtë, ndërsa Shërbimi për Kadastër dhe Paluajtshmeri i Komunës së Shtërpcës të obligohet që nga forma e prerë e aktgjykimit të kryej ndryshimet e nevojshme në aparatin kadastral, ashtu që si pronare në ngastrën e lartë përmendur t'a regjistroj paditësen, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në formë të prerë, si dhe e paditura të obligohet që t'i paguajë shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, ka administruar provat e propozuara nga palët ndërgjyqëse dhe pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.22/12, të datës 20.04.2014, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se kërkesëpadija e paditëses është tërësisht e pa bazuar, për faktin se paditësja me asnjë provë nuk ka arritur të argumentojë dhe të vërtetojë pretendimet e saj për fitimin e të drejtës së pronësisë ndaj paluajtshmerisë kontestuese në bazë të mbajtjes. Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë (edhe ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë), është vërtetuar se ngastra kadastrale 1419-0 këtu lëndore udhëhiqet si pronë shoqërore- si rrugë jo e kategorizuar në sipërfaqe prej 90 m2 ZK Shtërpcë, e cila është formuar në bazë të aeroinqizimit në vitin 1969 dhe aparatit kadastral e cila gjendet prej datës 01.01.1967. Më tutje ka arsyetuar se baza juridike e kërkesëpadiës së paditëses është tërësisht e pabazuar, ngase sipas dispozitës se nenit 11 të Ligjit të Rrugëve, asnjë person fizik ose juridik nuk ka të drejtën e kërkesës pronësore që ka të bejë me rrugën publike ose pjesë të rrugës publike. Më tutje ka arsyetuar se pala paditëse këtë të drejtë nuk e ka vërtetuar as me anë të mbajtjes dhe shfrytëzimit të saj nga ana e paraardhësve juridik e as nga ana e saj, sepse nuk janë përmbushur kushtet ligjore që kjo e drejtë të pranohet sipas mbajtjes, kjo nga shkakun se prona e paraardhësve të paditëses nuk ka qenë ligjore e as me mirëbesim, por me keqbesim, sepse e kanë ditur se sipërfaqja lëndore sipas qëllimit të saj paraqet rrugë të cilën e kanë shfrytëzuar pronarët e ngastrave përreth për të kaluar tek ngastrat e tyre, e përveç kësaj kjo ngastër asnjëherë nuk është evidentuar në emër të tyre. Duke pasur paarsysh se asnjë person fizik apo juridik nuk ka të drejtën e kërkimit të pronës që ka të bejë me rrugën publike ose me pjesën e rrugës publike, nga e cila rezulton se paditësja nuk ka të drejtë të kërkojë vërtetimin e të drejtës së pronësisë në sipërfaqe lëndore e cila paraqet rrugë publike të pakategorizuar, e cila udhëhiqet nga e paditura Komuna e Shtërpcës. Gjithashtu ka theksuar se paditësja nuk ka qenë me mirëbesim me ndërtimin e saj, pasi që nga provat e administruara është konstatuar se paluajtshmeria kontestuese evidentohet si pronë shoqërore. Mbi bazën e të lartëcekurave, gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara, nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të

LPK-së, dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes rreth kërkesëpadisë së paditëses, e parashtruar kundër të paditurës Komuna e Shtërpcës, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye aktgjykimi i atakuar është dashur të vërtetohet në tërësi. Gjithashtu edhe dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për mos themelësinë e kërkesëpadisë së paditëses, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Në rastin konkret, me shikim në ankesën e paditëses, por edhe në shkresat e lëndës, rezulton se paditësja në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë ka parashtruar padi kundër të paditurës, përmes të cilës ka kërkuar që gjykata të merr aktgjykim meritor, përmes të cilit asaj do i njëjtojë drejta e pronësisë në palujtshmerinë e ngastrës nr.1419, sipas fletëposedimi nr.628 Shtërpcë, sipas bazës së mbajtjes për shumë vite. Me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses, gjykata e shkallës së parë me të drejtë është thirrur në dispozitën e nenit 11 të Ligjit të Rrugëve (Ligj. Nr.2003/11, i nxjerr nga Kuvendi i Kosovës), për shkak se sipas saj, nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga kjo dispozitë ligjore, pasi që paditësja e ka ndërtuar objektin e saj, në pronë shoqërore, ndërsa e njëjta nuk ka qenë me mirëbesim, pasi që e ka ditur se po ndërtonte në tokën e huaj. Mbi bazën e kësaj gjendje, për gjykatën e shkallës së dytë rezulton se fakti i keqëbesimit të paditëses në rastin konkret, është provuar dhe arsyetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga gjykata e shkallës së parë. Gjykata e Apelit vlerëson se mirëbesimi paraqet një gjendje përmes të cilës ai në vetvete supozohet se ekziston deri sa nuk provohet e kundërta, megjithatë duke pasur parasysh faktin se kemi të bëjmë me pronën shoqërore, pronë kjo specifike e cila gëzon një mbrojtje dhe pozitë specifike në të drejtën aktuale pozitive, gjykata e shkallës së parë me plotë të drejtë dhe në mënyrë të ligjshme ka vendosur sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të ankueses, se këtë paluajtshmëri e kanë në posedim pa ndërprerje më shumë se 40 vite, me ndërgjegje duke e ndryshuar gjatë kohës në bazë të kontratës me gojë lidhur me paluajtshmerinë kontestuese me ish pronrin tani të ndjerin N.S. nga Shtërpca, të cilit i kanë dhënë tokë tjetër, pasi siç e kemi cekur edhe më lartë, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme e ka vërtetuar faktin se paditësja nuk ka ofruar asnjë provë materiale që i mbështet pretendimet e tilla. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit vëren se me dispozitën e nenit 11 të Ligjit të Rrugëve është paraparë se: ***“Asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike”***. Përfundimisht Gjykatës së Apelit i ka rezultuar se pala paditëse me asnjë provë të vetme nuk ka arritur të provojë para gjykatës së shkallës së parë se të njëjtës i takon e drejta e pronësisë mbi ngastrat kontestuese, referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, kjo edhe për faktin se e njëjta me keqëbesim e ka përvetësuar pronën shoqërore. Në këtë drejtim, edhe pretendimet e palës

paditëse që të njëjtës i takon e drejta e pronësisë mbi ngastrën kontestuese në bazë të parashkrimit fitues dhe atë bazuar në nenin 28 parag.4 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (i vitit 1980) dhe nenit 40 parag. 1 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (Ligj.nr.03/L-154), janë plotësisht të pabazuara. Kjo për faktin se siç e kemi cekur edhe më lartë, nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pronë publike dhe shoqërore (edhe nëse e njëjta është e kategorizuar si rrugë publike), në bazë të parashkrimit fitues. Kjo duke u bazuar në dispozitat e LMTHJP-së, përkatësisht në nenin 29 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike - Pronësore (LMTHJP), parashihet se *“mbi sendin në pronësi shoqërore, e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrim fitues”*. Edhe pse me ndryshimet e mëvonshme të LMTHJP-së, neni në fjalë rezultoi të jetë i fshirë, gjykata vlerëson se bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi, respektivisht Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/59 për Ndryshimin e Rregullores nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë, në rastin konkret zbatohet LMThJP, i cili ka qenë në fuqi me 22.03.1989, e jo edhe ndryshimet e mëvonshme të tij. Në anën tjetër, Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, nuk parasheh ndonjë dispozitë e cila rregullon çështjen e fitimit të së drejtës së pronësisë me parashkrim fitues mbi pronën publike apo shoqërore, edhe pse në rastin konkret siç e kemi cekur edhe më lartë, ligj special i cili zbatohet në rastet kur kemi të bëjmë me ngastra të cilat kategorizohen si rrugë publike, është Ligji i Rrugëve.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2569/14, datë 30.10.2018

Kryetari i Kolegjit,
Lumni Sallauka